

## SHTYLLA II ÇËSHTJE PRAKTIKE ADMINISTRATIVE

### *Përdorimi i Pronësisë Industriale si Instrument Financimi*

*Nga Av. Eni Kalo*

*Partner tek Kalo & Associates*

### I. ABSTRAKTI

Ky artikull trajton të drejtën e përdorimit të pronësisë industriale, e cila përfaqëson një aset të vlefshëm për shoqëritë si burim i aksesit në financim. Në paragrafin e parë jepet një shpjegim i shkurtër i të drejtës së pronësisë industriale, të njohur nga legjislacioni shqiptar dhe të mekanizmit për të përfituar financim nga kjo e drejtë mbi pasuri të paprekshme. Paragrafi i dytë shqyrton dispozitat e reja ligjore të miratuara me anë të Ligjit Nr. 17/2017, datë 16.02.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9947 datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale” të ndryshuar”, në lidhje me regjistrimin e pengut mbi pronësinë industriale. Ndërsa paragrafi i fundit paraqet përfundime dhe rekomandime në lidhje me zbatimin praktik të këtij instrumenti financimi.

**FJALËT KYÇE:** Pronësi Industriale, Patentë, Disenjo industriale, Markë tregtare, Barrë siguroese, Peng.

#### SHKURTIME

**DPPI**

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, që është autoriteti kompetent në fushën e pronësisë industriale

**Kodi Civil**

Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

**Ligji 9947**

Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar

**Ligji Ndryshues**

Ligji Nr. 17/2017, datë 16.02.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9947 datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale” të ndryshuar”

**Ligji për Barrët Siguroese**

Ligji Nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguroese”, i ndryshuar

**OBPI**

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale<sup>1</sup>, e cila është një nga agjencitë e specializuara të OKB-së e krijuar në vitin 1976 për të nxitur veprimtarinë krijuese dhe për të promovuar mbrojtjen e pronësisë intelektuale në të gjithë botën. OBPI ka 189 vende anëtare, një nga të cilat është Republika e Shqipërisë.

**Të Drejtat PI**

Të drejtat e pronësisë industriale të përkufizuara nga Ligji PI të tilla si patenta, disenjo industriale, marka tregtare

### II. HYRJE TEK TË DREJTAT E PI-së NË SHQIPËRI DHE PËRDORIMI I TYRE SI INSTRUMENT FINANCIMI

<sup>1</sup> <http://www.wipo.int>

Të drejtat e PI-së janë të drejta pronësie mbi pasuri të paprekshme të rregulluara në mënyrë të posaçme nga Ligji 9947. Sipas këtij ligji, të drejtat kryesore të pronësisë industriale, mbi të cilat vlen të përqendrohemi në kuadër të këtij artikulli, janë patentat, markat tregtare dhe disenjot industriale. Patentat janë të drejta pronësie të dhëna për shpikjet në të gjitha fushat e teknologjisë, me kusht që këto shpikje të përbëjnë risi, të përmbajnë një hap shpikës dhe të jenë të zbatueshme në industri.

Nga ana tjetër markat tregtare janë shenja dalluese funksioni kryesor i të cilave është t'u mundësojnë konsumatorëve të bëjnë dallimin mes mallrave dhe shërbimeve të ofruara nga tregtarë të ndryshëm. Përsa i përket disenjove industriale, këto të fundit përkufizohen nga Ligji 9947 si karakteristikat e formës së jashtme të një produkti, zakonisht si aspekti dekorativ ose estetik i të gjithë produktit apo pjesëve të tij, që i jep atij një pamje të veçantë. Në parim, zotëruesi i të drejtës së pronësisë industriale të mbrojtur me Ligjin 9947, ka të drejtën ekskluzive ta përdorë atë dhe të pengojë përdorimin e kësaj të drejte, pa miratimin e tij/të saj, nga çdo palë e tretë.

Me anë të monopolit të dhënë nëpërmjet Ligjit 9947 (të përshkruar më sipër) të drejtat e PI-së kanë nisur të përbëjnë një pjesë gjithmonë e më të madhe të asetëve totale të shoqërive. Në një mjedis ekonomik, siç është ai shqiptar, ku shumë biznese kanë bilance të shtrënguara, të drejtat e PI-së mund të konsiderohen si një pjesë thelbësore e portofolit të kolateralit të disponueshëm për huadhënësit dhe huamarrësit.

Në Shqipëri, mundësia për të siguruar financim me anë të përdorimit të të drejtave të pronësisë industriale, parashikohet fillimisht nga Ligji për Barrët Siguruese sipas të cilit "barra siguruese" përkufizohet si një e drejtë pronësie mbi një pasuri të luajtshme e cila mund të jetë e prekshme apo e paprekshme...dhe "pasuria e paprekshme" përkufizohet në mënyrë të tillë që përfshin edhe pronësinë intelektuale.

Në frymën e legjislacionit të zbatueshëm, barra siguruese mbi një të drejtë PI-je konsiderohet jo poseduese, që do të thotë që ky aset mbetet në pronësi të huamarrësit i cili është i lirë ta përdorë atë gjatë biznesit të tij/të saj, por nuk mund ta transferojë atë tek asnjë palë e tretë duke qenë se barra siguruese regjistrohet në Regjistrin e Barrëve Siguruese. Ky regjistër është krijuar me qëllim regjistrimin e barrëve siguruese, të drejtave dhe pretendimeve në lidhje me to, në përputhje me Ligjin për Barrët Siguruese çdo ligj tjetër i cili kërkon apo lejon regjistrimin në Regjistrin e Barrëve Siguruese.

Praktikisht, zotëruesi i një të drejte PI-je, si për shembull i një marke tregtare, që është përdorur nga zotëruesi gjatë ushtrimit të biznesit të tij/të saj dhe si rrjedhojë e këtij përdorimi ka fituar njëfarë vlere, mund të ofrojë këtë pasuri të paprekshme si barrë siguruese në favor të një institucioni financiar, i cili merr përsipër të financojë zotëruesin e markës tregtare bazuar në barrën siguruese të vendosur mbi këtë të fundit.

Pas lidhjes së marrëveshjes së huasë mes palëve dhe regjistrimin e barrës siguruese në Regjistrin e Barrëve Siguruese, zotëruesi i markës tregtare do të vazhdojë të mbetet pronari i saj, duke gëzuar mbi markën tregtare të gjitha të drejtat që vijnë nga Ligji 9947 (si për shembull vazhdimin e përdorimit të markës tregtare). Megjithatë, zotëruesi i markës tregtare nuk ka të drejtë ta transferojë këtë të drejtë tek

një palë e tretë për shkak të barrës siguroese që është regjistruar mbi atë markë tregtare. Në rast se zotëruesi i markës tregtare dështon në përmbushjen e detyrimit të tij që rrjedh nga marrëveshja e huasë, institucioni financiar do të ketë të drejtë të kërkojë transferimin e markës tregtare në zotërim të tij.

Megjithëse Ligji për Barrët Siguroese e parashikon këtë mundësi, përdorimi i një metode të tillë financimi është përdorur pak herë në praktikë. Ky hezitim ndoshta e ka origjinën në faktin se në momentin kur ligji hyri në fuqi, operatorët e biznesit kishin një ndërgjegjësim të ulët përsa i përket të drejtave të pronësisë industriale, që do të thotë se në atë kohë të drejtat e pronësisë industriale nuk mund të konsideroheshin si një aset i vlefshëm që mund të përdorej për të rritur kreditimin. Për më tepër, metoda e përshkruar më sipër nuk ka një ndikim kaq të madh mbi zotëruesin e të drejtës së pronësisë industriale, sa e ka mbi huadhënësin, i cili jep hua bazuar në të drejtën e pronësisë industriale, e cila mund humbas papritur të gjithë vlerën e saj për shkak të veprimeve apo mos veprimeve të zotëruesit të PI-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij të biznesit.

Më vonë, përkufizimi i “barrës siguroese” i dhënë nga Ligji për Barrët Siguroese, ju nënshtrua një ndryshimi në vitin 2013 me anë të Ligjit Nr. 132/2013 i cili përjashtoi nga përkufizimi termin “pasuri e paprekshme”, duke përjashtuar kështu mundësinë e rritjes së kreditimit me anë të përdorimit të të drejtës së pronësisë industriale në bazë të Ligjit për Barrët Siguroese. Pavarësisht këtij ndryshimi, asgjë nuk mund të pengonte palët që të përdornin të drejtat e PI-së si instrument për të siguruar financim duke nënshkruar të një marrëveshje të bazuar në dispozitat e Kodit Civil.

Megjithatë përdorimi i kësaj metode në praktikë, do të ishte e ndryshme nga metoda e përshkruar më sipër: huadhënësi do të bëhej pronari i të drejtës së PI-së dhe si rrjedhojë do të përfitonte nga monopoli i dhënë me anë të Ligjit 9947. Kjo metodë mund të konsiderohet problematike në praktikë, sepse me shumë mundësi bizneset nuk do të merrnin përsipër rrezikun që të humbnin pronësinë e të drejtave të PI-së, sepse gati gjithmonë këto të drejta janë të domosdoshme për suksesin e biznesit të tyre, meqenëse ato përfshijnë emrin e mirë të shoqërisë.

Zgjidhja në favor të të dyja palëve do të ishte që huadhënësi, i cili bëhet pronari i të drejtës së PI-së, t’i japë huamarrësit licencën e përdorimit ekskluziv të PI-së duke i mundësuar vazhdimin e biznesit të tij dhe ruajtjen apo rritjen e vlerës së PI-së. Bazuar në sa më sipër, duhet theksuar se përjashtimi i “pasurive të paprekshme” nga fusha e zbatimit të Ligjit për Barrët Siguroese në vitin 2013, e ndërlikoi në mënyrë të ndjeshme situatën edhe pse ky instrument financimi mund të përdoret bazuar në dispozitat përkatëse të Kodit Civil.

Siç u shpjegua më sipër, kjo çështje mbeti e pa rregulluar duke nisur nga viti 2013, megjithatë në vitin 2016 Ligji për Barrët Siguroese ishte objekt i një ndryshimi tjetër nga Ligji Nr. 101/2016 duke risjellë përkufizimin e “barrës siguroese” që ekzistonte përpara ndryshimit të vitit 2013 (d.m.th duke ri futur termin “pasuri e paprekshme” në përkufizim). Mund të konfirmohet se tashmë ndërgjegjësimi i rëndësisë së të drejtave të PI-së është rritur ndjeshëm, megjithatë përdorimi i kësaj metode financimi duhet ende të provohet në praktikë. Ndryshimet e fundit të Ligjit 9947 (të shpjeguara në paragrafin e mëposhtëm) dëshmojnë qartësisht vullnetin e qeverisë për të promovuar më tej të drejtat e PI-së dhe për

të inkurajuar operatorët e biznesit duke përfshirë në Ligjin 9947 dispozita për regjistrimin e pengut mbi të drejtat e PI-së.

### **III. DISPOZITAT E REJA TË LIGJIT NDRYSHUES MBI REGJISTRIMIN E PENGUT MBI TË DREJTËN E PI-SË**

Një nga qëllimet kryesore të Ligjit Ndryshues ishte krijimi i kuadrit ligjor për garantimin e të drejtave të PI-së dhe përdorimit të tyre si kolateral, në mënyrë që t'u jepej këtyre të drejtave një vlerë tregu e cila ka qenë e shpërfillur deri më tani. Në fakt kjo çështje ishte e rregulluar edhe përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Ndryshues, për këtë arsye ndryshimi nuk do të konsiderohet si një risi, por si një përpjekje për të plotësuar legjislacionin ekzistues, me anë të vendosjes, mbi palët e një marrëveshjeje pengu mbi të drejtat e PI-së të mbrojtura me Ligjin 9447, të detyrimit për ta regjistruar këtë marrëveshje tek DPPI-ja.

Përkatësisht, Neni 36/a i Ligjit Ndryshues sjell të drejtën e vendosjes së pengut mbi patentat e shpikjeve, duke parashikuar se marrëveshja e pengut do të regjistrohet në regjistrin e patentave në mënyrë që të prodhojë efekte ligjore për palët e treta. Megjithatë një marrëveshje e këtij lloji, mund të prodhojë efekte ndaj palëve të treta edhe përpara regjistrimit, në rast se provohet që pala e tretë ishte në dijeni të ekzistencës së kësaj marrëveshjeje.

Për më tepër, Nenet 129/a dhe 163/a të Ligjit Ndryshues, parashikojnë mundësinë e vendosjes së pengut mbi një diseno industriale/markë tregtare dhe kërkesën për të regjistruar marrëveshjen e pengut në regjistrin e disenjove industriale/markave tregtare në mënyrë që marrëveshja të prodhojë efekte ligjore. Regjistrimi i pengut publikohet më pas në buletin e DPPI-së. Siç është përcaktuar në Ligjin Ndryshues forma dhe përmbajtja e aplikimit për regjistrimin e pengut do të vendoset me anë të Vendimeve të Këshillit të Ministrave<sup>2</sup>, specifik për secilën nga të drejtat e PI-së.

Vlen të përmendet se regjistrat ku do të regjistrohen pengjet e PI-ve nuk janë të lidhura me Regjistrin e Barrëve Siguruese të krijuar sipas Ligjit për Barrët Siguruese. Në fakt Ligji 9447 nuk i referohet në asnjë rast Regjistrin të Barrëve Siguruese, si rrjedhojë regjistrimi në regjistrin e PI-ve, logjikisht, duhet të konsiderohet si një kërkesë shtesë e regjistrimit në regjistrin e Barrëve Siguruese.

### **IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Financimi i bazuar tek asetet, duke vendosur PI-të si kolateral, mund të jetë ideal për bizneset në vështirësi, duke qenë se vendosja e PI-ve si kolateral përfaqëson një formë më të sigurt dhe të qëndrueshme garancie sesa performanca financiare apo aftësitë prodhuese të mjeteve monetare. Kjo përjasje mund të rrisë kapacitetin huamarrës të korporatave duke u mundësuar operatorëve ekonomik arritjen e objektivave të tyre financiare. Megjithatë një nga mangësitë kryesore të sistemit, është mungesa e metodave të përshtatshme të vlerësimit të të drejtave të PI-ve, e cila përbën një aspekt

<sup>2</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1707, datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit" i ndryshuar; Vendim i Këshillit të Ministrave 1706, datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e markave tregtare të shërbimit" i ndryshuar; dhe Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 381, datë 08.04.2009 "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e disenjove industrial" i ndryshuar.

thelbësor të procedurës së financimit me anë të PI-ve, duke marrë parasysh nevojën që ka institucioni financiar për të pasur informacion mbi vlerën e këtyre aseteve në kohën e kryerjes së transaksionit.

Mungesa e një metode vlerësimi të përcaktuar, mund të provokojë shmangien si të operatorëve të bizneseve ashtu edhe të huadhënësve nga përdorimi i këtij opsioni si instrument për sigurimin e financimit. Krijimi dhe konsolidimi i parimeve të përgjithshme për vlerësimin e përshtatshëm të PI-ve duhet të jetë sfida e ardhshme e Shqipërisë. OBPI-ja ka dhënë disa udhëzime për vlerësimin e pronësisë intelektuale, të cilat mund të përdoren nga qeveria Shqiptare si një pikë e sigurt referimi për krijimin dhe zbatimin e një sistemi vlerësimi të pronësisë intelektuale.

Përsa i përket ndryshimeve të fundit të Ligjit 9447, duhet vënë në dukje se zbatueshmëria e këtyre dispozitave nuk është provuar ende në praktikë dhe mund të jetë problematike për shkak të potencialit të tyre që të jenë në konflikt me Ligjin për Barrët Siguruese dhe Kodin Civil<sup>3</sup>, si rrjedhojë mund të jetë e nevojshme që të kryhen ndryshime të tjera të Ligjit 9447.

---

<sup>3</sup> Ligji Ndryshues përdor termin “peng” i cili ka një karakter posedues, ndërsa Ligji për Barrët Siguruese dhe Kodi Civil përdorin termin “barrë siguruese” për pasuritë e paprekshme.